




Komuna e Vitisë
FAMILJARE NË VITI
Main Health Family Center of Vitia
Glavni Centar Porodicni Medicine



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË
Municipality of Vitia
Opstina Vitina

Raport pune Janar – Dhjetor 2025

Dr.Vjollca Kadolli-Halili
Drejtoreshë e QKMF-së ne Viti

Viti, 2025

Përmbajtja

Hyrje	3
VIZIONI	5
MISIONI.....	5
ORGANOGRAMI NË QENDRËN KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE NË VITI	6
Struktura e të punësuarve në QKMF Viti:.....	7
Sipërfaqja e institucioneve shëndetësore në Komunën e Vitisë:.....	8
Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në QKMF-Viti.....	9
1. Shërbimet primare:	9
1.Mjekësia Familjare	9
2.Emergjenca.....	9
3.Stomatologjia.....	9
4.Imunizimi dhe vaksinimi.....	9
5.Laboratori	9
6 .Shërbimi Radiologjik	9
7.Barnatorja.....	9
2. Shërbimet specialistike	10
1.1 Mjekësia Familjare.....	10
1.2 Shërbimi i urgjencës primare.....	10
1.3 Stomatologjia.....	10
1.4. Shërbimi i Vaksinimit.....	11
1.5. Laboratori	12
1.6. Shërbimi radiologjik.....	13
1.7. Barnatorja.....	13
2. Shërbimet specialistike	13
2.1.Pediatra	13
2.2. Mjekësia interne	13
2.3. Gjinekologjia.....	13
Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë	14
Kujdesi ne grup në 1000 ditët e para	14
Kujdesi paliativ	14
Dhoma për Edukim dhe Promovim Shëndetësorë	15
QMF-të dhe AMF-të të cilat kanë funksionuar gjatë kësaj periudhe në Komunën e Vitisë janë:	

.....	15
Funksionaliteti i institucioneve nëpër fshatra:	16
Qendra e Mjekësisë Familjare në Pozheran	17
Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme	17
Qendra e Mjekësisë Familjare në Smirë	17
Qendra e Mjekësisë Familjare në Sadovinë të Jerlive	18
Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Skifteraj	18
Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Beguncë	18
Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Terpezë	18
Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Stubëll e Epërme	18
Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Letnicë	18
Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Remnik	19
Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Gushicë	19
Sistemi Informativ Shëndetësor	19
Tabela e raportit të SISH për periudhën Janar – Dhjetor 2025	20
Cilësia e shërbimeve shëndetësore:	20
Shërbimi i administratës	21
Njësia për resurse humane	21
Edukimi i vazhdueshëm profesional	22
Promovimi dhe edukimi shëndetësor gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 janë realizuar këto aktivitete :	23
Aktivitete tjera	24
INVESTIMET KOMUNALE	25
DONACIONET	25
Planet për të ardhmen	25
Sfidat	26
Rekomandimet	26
Krahasimi i shërbimeve të ofruara për periudhat Janar- dhjetor 2022, 2023, 2024 dhe 2025	27

Hyrje

Komuna e Vitisë ka 35566 banorë rezident, sipas ASK të vitit 2024.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka kryer shërbime që të jetë sa më afër qytetarëve dhe të jenë në shërbim të kërkesave të tyre, duke u munduar që të rregulloj sadopak mirëqenien e tyre si në aspektin shëndetësor, ashtu edhe në atë social dhe psikologjik.

Vitin 2025 QKMF në Viti ka filluar me ofrim të shërbimeve shëndetësore, si dhe me realizimin e planit vjetor paraprak dhe aktivitete tjera, duke u fokusuar në:

- Ofrim të shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë, përfshirë qytetarët e Komunës së Kllokotit që kërkojnë shërbime në QKMF dhe në shtëpi,
- Implementimi i konceptit të mjekësisë familjare duke u bazuar në normat ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Udhëzimeve Administrative.
- Ngritjen e cilësisë në të gjitha shërbimet shëndetësore,
- Furnizim më të mirë me terapi sipas listës esenciale, të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë
- Trajnime dhe ligjërata të stafit shëndetësorë, bazuar në planin vjetor të ZHVP-së dhe EVP-së, si dhe trajnime tjera nga organizata të ndryshme si dhe nga niveli qendror
- Si dhe zbatimi i planit të punës sipas objektivave të parapara për vitin 2025

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti ka rifilluar punën me 16.06.1999 pas përfundimit të luftës.

Sot QKMF në Viti ka të punësuar 127 punëtorë, prej tyre 24 mjekë, 3 specialistë, 5 stomatologë, 1 Farmacist, 68 infermier, 7 laborantë, 4 mami, dhe 15 punëtorë teknik dhe administratë.

Ky raport përmbledh punën dhe aktivitetet e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) gjatë periudhës gjashtëmujore, nga janar 2025 deri më dhjetor 2025.

Qëllimi i këtij raporti është të pasqyrojë mënyrën e funksionimit të shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor, realizimin e objektivave, sfidat e hasura dhe rekomandimet për përmirësim të mëtejshëm.

Gjatë kësaj periudhe, QKMF-ja ka vazhduar të ofrojë shërbime bazë shëndetësore për popullatën, duke përfshirë mjekësinë familjare, kujdesin emergjent, shërbimet laboratorike, radiologjike, specialistike si : internistike, gjinekologjike dhe pediatrike, shërbimet për nënat dhe fëmijët, shërbimet e kujdesit paliativ dhe kronik si dhe vaksinimin dhe imunizimin. Pavarësisht sfidave të natyrës organizative dhe resurseve të kufizuara, stafi është angazhuar maksimalisht për të ofruar kujdes cilësor dhe të vazhdueshëm për të gjithë qytetarët.

Ky raport gjithashtu përfshin të dhëna statistikore mbi numrin e vizitave, llojet e shërbimeve të ofruara, aktivitetet parandaluese dhe edukative, si dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera lokale dhe qendrore në fushën e shëndetësisë.

VIZIONI

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta për të gjithë qytetarët, ofrim i kujdesit shëndetësorë cilësorë, gjithpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë qytetarët, duke promovuar shëndetin, parandalimin dhe mirëqenien në komunitet të gjitha këto në harmoni me Strategjinë Sektoriale Shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës, ku objektiva e përgjithshme e strategjisë të KPSH-së është ruajtja dhe përparimi i shëndetit të populates.

MISIONI

Misioni i QKMF-së në Viti është ofrimi i shërbimeve shëndetësore të qasshme dhe cilësore, të barabartë për të gjithë qytetarët e komunës, pa dallim feje, etnie, race, gjinie dhe grupet e marginalizuara, si dhe ruajtja e shëndetit, edukimi shëndetësor dhe promovimi i mënyrave të shëndetshme të jetesës.

Fillimisht do të paraqesim organogramin e resurseve humane në QKMF- Viti:

ORGANOGRAMI NË QENDRËN KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE NË VITI



Struktura e të punësuarve në QKMF Viti:

► Struktura e të punësuarëve në QKMF-Viti është si vijon:

Titulli	Nr.Puntorëve	F	M
Sp.Mjek.Familjare	14	7	7
Mjek të Përgjithshëm	10	1	9
Sp.Internist	1	0	1
Sp.Gjinekologji	1	1	0
Pediatër	1	1	0
Stomatolog	5	3	2
Farmacist	1	1	0
Tek.Farmacisë	1	1	0
Tek.Radiologjisë	1	0	1
Mami	4	4	0
Infermier	65	52	13
Laborant	8	3	5
Shofer	9	0	9
Lavanderi	1	1	0
Kuzhinë	1	1	0
Furnizuese	1	1	0
Administratë	3	2	1
Totali	127	79	48
Përqindja	100%	62.2%	37.7%

Titulli	Nr.Puntorve	F	M
MJEKË TË PËRGJITHSHËM DHE FAMILJAR	24	8	16
SPECIALIST TJERË	3	2	1
Stomatolog	5	3	2
Farmacist	1	1	0
Infermier	79	60	19
Administratë	3	2	1
Shofer	9	0	9
Punetore teknik	3	3	0
Totali	127	79	48
Përqindja	100%	62.2%	37.7%

Sipërfaqja e institucioneve shëndetësore në Komunën e Vitisë:

Nr	Emri	Njesia	Sipërfaqja	
1	QKMF-Viti	m2	2659.92	
2	Urgjenca -Viti	m2	381.36	
3	QMF-Pozheran	m2	1238.38	
3	QMF-Sadovine e Jerlive	m2	160.7	
4	QMF - Smirë	m2	138	
5	QMF-Sllatinë e Epërme	m2	150	
6	AMF-Remnik	m2	250.13	
7	AMF-Gjylekar	m2	134.47	
8	AMF-Letnicë	m2	214.2	
9	AMF-Stubëll	m2	152.52	
10	AMF Tërpezë	m2	204,21	
11	AMF-Goshice	m2	175	
12	AMF - Begunce	m2	147	
	Totali	m2	6005.89	

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në QKMF-Viti

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti ofron shërbime 24 orëshe. Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare bëhet ofrimi i shërbimeve mjekësore për qytetarë. Të gjitha shërbimet mjekësore familjare, stomatologjike, pediatrike, interne, radiologjike dhe laboratorike kryhen vetëm gjatë ndërrimit të parë të orarit të punës.
- Qendra e urgjencës primare punon gjatë 24 orëve për çdo ditë të javës, ndërsa mjekësia familjare punon në orarin 08.00-16.00 çdo ditë të javës.
- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 në QKMF janë ofruar 490126 shërbime shëndetësore. KPSH si portë hyrëse në Sistemin e Kujdesit Shëndetësor, si pikë kordinuese përfshinë këto shërbime:

1. Shërbimet e promovimit shëndetësorë përfshinë: informimin, komunikimin dhe edukimin brenda institucioneve dhe në komunitet,
 2. Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese,
 3. Shërbimet esenciale kurative të mjekësisë familjare,
 4. Ndërhyrjet e vogla kirurgjikale,
 5. Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent,
 6. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike,
 7. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për kujdesin paliativ,
 8. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë,
 9. Shërbimet e shëndetit riprodhues,
 10. Shërbimet e shëndetit oral, parandalues dhe shërbimet specialistike stomatologjike;
 11. Vizitat shtëpiake për nënën dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç,
 12. Vizitat sistematike në shkolla,
 13. Shpërndarjen e barnave nga lista esenciale,
 14. Shërbimin e Rentgenit,
 15. Shërbimet laboratorike,
- Shërbimet në QKMF -Viti janë të natyrave të ndryshme dhe përfshijnë:

1. Shërbimet primare:

- 1.Mjekësia Familjare
- 2.Emergjenca
- 3.Stomatologjia
- 4.Imunizimi dhe vaksinimi
- 5.Laboratori
- 6 .Shërbimi Radiologjik
- 7.Barnatorja

2. Shërbimet specialistike

- a. Pediatria
- b. Shërbimi i sëmundjeve të brendshme (Internisti)
- c. Gjinekologjia

1.1 Mjekësia Familjare

Ka ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë dhe të një numër te konsiderueshëm të Komunës së Kllokotit të të gjitha moshave pa dallim. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **34709** vizita mjekësore. Ndersa jane kryer 46515 shërbime shëndetësore.

1.2 Shërbimi i urgjencës primare

Shërbimi i Urgjencës ofron shërbime shëndetësore **24 orë** ditë, gjatë tërë javës.

Në shërbimin e urgjencës kryhen të gjitha shërbimet e ndihmës së parë, kontrolla mjekësore, këshilla, vizita në teren gjate traumave dhe aksidenteve te ndryshme, kirurgji e vogël, ndërrim kateteri, lidhje dhe pastrim i plagëve , ordinimi dhe trajtimi me terapi parenterale, oksigjenoterapia etj.

Në këtë shërbim janë të organizuara edhe kujdestaritë gjatë natës , vikendeve dhe festave , në bazë të orarit të planifikuar më parë. Autoambulancat janë monitoruar në vazhdimësi nga ekipet kujdestare dhe vozitësit, në drejtim të funksionimit sa më të rregullt të saj. Në dispozicion kemi 5 autoambulanca në funksionalitet të plotë. Janë realizuar edhe shërbimet e transportit për në qëndren e dializës në Spitalin Regjional në Gjilan, 6 ditë në jave (nga e hënë – shtunë), në dy ndërrime.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **66600** vizita mjekësore në shërbimin e urgjencës, ndërsa në tërësi janë ofruar **147207** shërbime shëndetësore

1.3 Stomatologjia

Shërbimi i stomatologjisë ka ofruar shërbime stomatologjike në orarin 8:00-16:00, 6 ditë në javë, e hënë -e shtune. Këto shërbime ofrohen në QKMF-Viti , QMF- Pozheran dhe AMF-Tërpezë.

Shërbimet të cilat ofrohen janë:

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar 5677 vizita stomatologjike, si dhe 9760 shërbime stomatologjike.

1. Preventivë
2. Shërim i dhëmbit
3. Drenim
4. Incizion i dhëmbit të infektuar
5. Mbushje e dhëmbit
6. Shërbimet e pedodoncisë,
7. Pastrim të gurëve në dhëmbë,
8. Nxjerrje e dhëmbit etj.

1.4. Shërbimi i Vaksinimit

Shërbimi i vaksinimit në mënyrë të vazhdueshme ka punuar në ngritjen e cilësisë profesionale të stafit shëndetësor, poashtu edhe në edukimin e qytetareve në ngritjen e vetëdijes për rendësinë e promovimit dhe parandalimit të sëmundshmërisë së fëmijëve dhe rendesinë e vaksinimit në femijeri. Janë mbajtur takime me prindërit për rendesinë e vaksinimit me HPV, neper fshatra të ndryshme.

Ka bërë planin vjetor dhe ka realizuar planin në perpikmeri në vaksinimin e fëmijëve parashkollor dhe shkollor në tërë teritorin e Komunës së Vitise dhe Komunës së Klokotit.

Gjithsejt periudhës janar-dhjetor 2025 në shërbimin e vaksinimit janë ofruar 16752 shërbime.

Formulari për Raportimin e Përfshirjes me Vaksinim Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Viti

Periudha: Janar - Dhjetor 2025

0

Grup-mosha		Fëmijet e planifikuar për vit	Fëmijet e planifikuar për muaj
0-11 muaj (BCG, HepB, DTaP, IPV, Hib,PCV,Rota)		510	42
12- 23 muaj (MMR, PCV,DTaP, IPV,Hib)		475	1
24-59 muaj (Fëmijët e mbeturë)	IPV/bOPV, DTP,Hib,HepB	12	39
	IPV/bOPV,DPT,PCV	15	1
	MMR	20	1
Fëmijët e klasës së I-rë (DT,bOPV,MMR)		530	46
Te mbetur nga kl I-rë (DT,bOPV,MMR)		0	0
Fëmijët e klasës së VI-të (dT,bOPV,HPV) / vajza		480	37
Te mbetur nga kl VI-të (dT,bOPV,HPV)		0	0
Fëmijët e shkollës mesme (dT)		350	29

Vaksinat	0-11 muaj (2024-2025)	12-23 muaj (2023-2024)	24-59 muaj	Kl.I-rë	Të mbetur	Kl VI-të	Të mbetur	Kl XII-të	Mbi 59 muaj	TOTALI
BCG në lindje	4									4
Hep.B 1 në lindje	4									4
HepB 2	370									370
HepB 3	453									453
DTaP-IPV-Hib 1	541									541
DTaP-IPV-Hib 2	501									501
DTaP-IPV-Hib 3	468									468

Rota 1	541									541
Rota 2	496									496
PCV 1	541									541
PVC 2	485									485
MMR 1		475	12							487
PCV 3		366								366
DTaP-IPV-Hib (12-18 m) ⁴		213								213
PCV (12-23m)										
Vaksinat	0-11 muaj	12-23 muaj	24-59 muaj	KI.I-rë	Të mbetur	KI VI-të	Të mbetur	KI XII-të	Mbi 59 muaj	TOTALI
bOPV r2 (6 vjeç)				683	146					829
DT (6 vjeç)				570	84					654
MMR r (6 vjeç)				570	84					654
bOPV R3 (12 vjeç)						467				467
Td (12 vjeç)						467				467
HPV (12 vjeç)						467				467
Td (17 vjeç)								347		362
Hib										
Meningovax										
Pneumovax 23v										

1.5. Laboratori

Shërbimi i laboratorit ofron shërbime në orarin 8:00-16:00, 6 ditë në javë, e hënë - e shtunë. Këto shërbime ofrohen në QKMF-Viti dhe QMF- Pozheran. Është bërë furnizimi me material të nevojshëm për funksionimin normal të laboratorit. Janë ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë pacientët të cilët kanë kërkuar shërbime laboratorike në institucionin tonë. Janë bërë në vazhdimësi edhe analiza e HBA1C, si shërbim i ri. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **119610 shërbime laboratorike**. Furnizim me reagenca në vlerë prej **29684 euro**.

1.6. Shërbimi radiologjik

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **1307** shërbime radiologjike. Rentgeni punon ne orarin e rregullt 8:00-14:00, çdo ditë pune. Gjatë tetorit 2025 janë realizuar falas 124 mamografi.

1.7. Barnatorja

Është bërë planifikimi me kohë për furnizim me barna dhe material hargjues për vitin 2025.

Janë kryer në mënyrë të rregullt porositë mujore për furnizim me barna dhe material hargjues nga Ministria e Shëndetësisë, kryesisht përmes sistemit SMFK.

Është bërë distribuimi i barnave dhe materialit hargjues në QKMF dhe njësitë e saj.

Është bërë furnizimi i pacientëve me barna esenciale dhe insulinë,

Furnizimi me barna përmes listes esenciale ka qenë në përqindje 45,70 %, ndërsa me material hargjues 70.19 %, ndërsa me insulinë 100%.

Për faktin që furnizimi ka qenë jo i kënaqshëm nga MSH përmes listës esenciale, jemi obliguar të blejmë terapi dhe material shpenzues përmes kodit Shërbime dhe Mallra.

Gjatë kësaj periudhe kemi blerë me mjete vetanake, përmes kontratës me operatorin ekonomik në kuadër të shërbimeve dhe mallrave terapi dhe material hargjues në raste specifike në vlerë prej 27050 euro.

2. Shërbimet specialistike

2.1. Pediatria

Shërbimi i pediatriisë ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-16:00, çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **3154** vizita mjekësore dhe **345** këshilla mjekësore. Ne total jane ofruar **3537** shërbime pediatrike.

2.2. Mjekësia interne

Shërbimi i mjekësisë interne ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-16:00, çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore, kryesisht për të sëmurët kronik. Sëmundjet më të shpeshta kronike të evidentuara në shërbimin e mjekësisë interne janë sëmundjet kardiovaskulare, reumatologjike dhe të diabetit. Gjatë kesaj periudhe janë ofruar **525** vizita mjekësore, si dhe jane realizuar **485** EKG.

Në total jane ofruar 1564 shërbime.

2.3. Gjinekologjia

Shërbimi i gjinekologjisë ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-16:00, çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore për gratë shtatzëna. Gjatë këtij viti janë ofruar **1917** vizita mjekësore dhe **1484** ultrazë, **345** kontrolla gjinekologjike. Në tërësi janë ofruar **4154** shërbime shëndetësore në gjinekologji.

Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë

Kemi vazhduar me programin e vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë, ku gjatë kësaj periudhe janë kryer **1022** vizita. Përpos këshillave mjekësore, ne raste të veqanta përmes donatorëve familjet janë ndihmuar edhe me pako ushqimore dhe higjienike.

Klasat për nëna

“Klasat për nëna” është shërbim që i ofrohet grave shtatzëna, smëyre individuale, ose në prani të ndonjë familjari. Gjatë sesioneve jepen këshilla të ndryshme si: kujdesi para dhe pas lindjes, ushqyeshmeria e nënës dhe foshnjës, gjidhënia etj. Gjatë kësaj periudhe janë ofruar **548** shërbime.

Kujdesi ne grup në 1000 ditët e para

“Kujdesi ne grup në 1000 ditët e para” është shërbim që ofrohet nga infermiert e trajnuara paraprakisht. Gratë shtatzëna të të njejtës moshë të shtatzanisë përafërsisht marrin informacione dhe këshilla në mënyrë grupore si dhe shkëmbejnë informata në mes tyre për shtatzëninë, ushqyeshmërinë, apo sfidat e shtatzanisë. Ekipa ka realizur një grup të shtatzënave me **4** sesione.

Kujdesi paliativ

Shërbimi i kujdesit paliativ ka kryer me profesionalizëm shërbimet shëndetësore ndaj pacientëve me sëmundje kronike, dhe atyre të pa lëvizshëm, jo vetëm në Komunën e Vitise, por edhe në Komunën e Kllokotit. Në QKMF Viti funksionojnë dy ekipe në teren, në orarin 8:00-16:00, ekipa tjetër 15:00-23:00, ndërsa prej orës 23:00 vizitat në teren i kryen shërbimi i urgjencës. Deri në muajin tetor ka qenë edhe mjeku në permanencë, i cili është aktivizuar në nga rastet ditore kur ka nevojë për shërbim të mjekut në shtëpi, ndërsa pas muajit tetor pas pensionimit, shërbimi në shtëpi pas orës 23.00 kryhet nga infermierët dhe pacienti transportohet nëse ka nevojë për kontrollë mjekësore. Gjatë vitit 2025 janë ofruar **4400** shërbime shtëpiake. Kurse, vetëm shërbimi i urgjencës ka ofruar **2179** vizita në teren.

Dhoma për Edukim dhe Promovim Shëndetësorë


Në QKMF- Viti kemi filluar me 15 prill 2025 shërbimin e ri, Dhoma për Edukim dhe promovim shëndetësorë, ku pacientët me sëmundje kronike jongsjtitëse si: Diabetes Mellitus, Hipertension Arterial dhe Asthmae Bronchiale marrin shërbime falas.

Gjate kesaj periudhe kanë marre shërbime 443 pacientë, te cilet jane furnizuar edhe me libreza për sëmundjet e caktuara, ku 103 pacient janë furnizuar me libreza për diabet, 66 për hipertension dhe 4 për astmë.

QMF-të dhe AMF-të të cilat kanë funksionuar gjatë kësaj periudhe në Komunën e Vitisë janë:

1. QMF-Pozheran
2. QMF-Sllatinë e Epërme
3. QMF-Smirë
4. QMF- Sadovinë e Jerlive
5. AMF-Beguncë
6. AMF-Skifteraj
7. AMF-Stubëll
8. AMF-Tërpezë
9. AMF -Letnicë
10. AMF- Remnik
11. AMF-Goshicë
12. AMF Zhiti-jofunksionale

Më poshte është i paraqitur **organogrami i institucioneve shëndetësore në Komunën e Vitisë:**



Funksionaliteti i institucioneve nëpër fshatra:

1. Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Pozheran punohet 24 orë pa ndërprerë. Në kuadër të kësaj qendre ofrohen të gjitha shërbimet e mjekësisë familjare, shërbimet stomatologjike, si dhe kryhen shërbimet laboratorike gjatë ndërrimit të parë. Kurse, shërbimet e kujdestarisë ofrohen 24 orë.
2. Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme ofron shërbime infermierike dhe mjeku 1 ditë në javë.
3. Në QMF-në në fshatin Smirë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike.
5. Në QMF-në në fshatin Sadovinë të Jerlive punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike, ndërsa mjeku dy ditë në javë.
6. Në AMF-në e Skifterajt punohet dhe ofrohen shërbime çdo ditë punë nga ana e infermierëve përveç vikendit, ndërsa mjeku dy ditë në javë.
7. Në AMF-në e fshatit Beguncë ofrohen shërbime infermierike çdo ditë pune përveç vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë.

8. Në fshatin Tërpezë shërbimet mjekësore ofrohen çdo ditë pune nga infermieret, ndërsa mjeku 5 ditë në javë.

9. Në AMF-në në fshatin Stubëll e Epërme punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë.

10. Në AMF-në në Letnicë shërbimet shëndetësore nga infermierja ofrohen çdo ditë dhe mjeku ofrohen një ditë në javë.

11. Në AMF-në në fshatin Remnik punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë.

12. Në AMF-në në fshatin Gushicë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Pozheran

QMF në Pozheran ofron shërbime shëndetësore 24 orë. Në kuadër të kësaj qendre ofrohen të gjitha shërbimet e mjekësisë familjare, shërbimet stomatologjike, si dhe kryhen shërbimet laboratorike gjatë ndërrimit të parë. Kurse, shërbimet e kujdestarisë ofrohen 24 orë.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **43782** vizita shëndetësore, kurse janë ofruar **81246** shërbime infermierore.

Në shërbimin e stomatologjisë 1501 vizita, kurse janë ofruar 1630 shërbime stomatologjike.

Në shërbimin laboratorik janë ofruar 4521 vizita laboratorike dhe janë ofruar 57606 analiza laboratorike.

Në total në QMF - Pozheran janë ofruar 140482 shërbime të ndryshme shëndetësore.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme

Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme ofron shërbime infermierike dhe mjeku 2 ditë në javë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **84** vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **383** shërbime.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Smirë

Në QMF-në në fshatin Smirë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike. Për shkak të disa problemeve teknike infrastrukturore, mjeku nuk ka punuar gjatë kësaj periudhe. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 shërbime infermierike janë ofruar **gjithsejt 205 shërbime**.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Sadovinë të Jerlive

Në QMF-në në fshatin Sadovinë të Jerlive punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike, ndërsa mjeku dy ditë në javë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **58 vizita**, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **164 shërbime**.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Skifteraj

Në AMF-në e Skifterajt punohet dhe ofrohen shërbime çdo ditë punë nga ana e infermierëve përveç vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë. Gjatë vitit 2025 janë ofruar **78 vizita**, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **153 shërbime**.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Beguncë

Në AMF-në e fshatit Beguncë ofrohen shërbime infermierike çdo ditë punë përveç vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë (jo cdo javë, pasi kemi pasur mungesë të mjekëve). Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **16 vizita mjekësore**, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **328 shërbime**.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Terpezë

Në fshatin Tërpezë shërbimet mjekësore ofrohen çdo ditë punë nga infermieret, ndërsa mjeku 5 ditë në javë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **947 vizita mjekësore**, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **396 shërbime**. Janë bërë 6 ultrazë. Ka filluar shërbimi i stomatologjisë dhe janë ofruar 29 vizita dhe 46 shërbime stomatologjike.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Stubëll e Epërme

Në AMF-në në fshatin Stubëll e Epërme punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **124 vizita**, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **847 shërbime infermierore**.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Letnicë

Në AMF-në në Letnicë shërbimet shëndetësor nga infermierja ofrohen çdo ditë dhe mjeku

ofrohen një ditë në javë. Gjatë vitit 2025 janë ofruar **192** vizita, ndërsa janë ofruar gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 **290** shërbime infermierore .

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Remnik

Në AMF-në në fshatin Remnik punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë. Gjatë periudhës janar-qershor 2025 është ofruar 2 vizitë mjekësore, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **11** shërbime.

Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Gushicë

Në AMF-në në fshatin Gushicë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë ofruar **14** vizita, ndërsa shërbime infermierike janë ofruar **41** shërbime.

Sistemi Informativ Shëndetësor

Janë raportuar me kohë të gjitha raportet në të gjitha institucionet përgjegjëse si IRSHP -Gjilan, IKPSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Është përcjellur gjendja e sëmundshmërisë përmes formularëve të caktuar dhe është raportuar me kohë në institucionet përgjegjëse. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2025 kordinatori i SISH është përkujdesur për mirëmbajtjen e Sistemit të SISH-it, resetimin, kyqjen e user-aye të ri dhe mirmbajtjen e rrjetit, software-it dhe hardware-it në objektet e të gjitha njësitë tona. Më poshtë është tabela me raportet 12 mujore:

Tabela e raportit të SISH për periudhën Janar – Dhjetor 2025[illegible]

Shërbimet e ofruara nga punëtorët e angazhuar përmes kontratës për shërbime shëndetësore

Komuna e Vitisë ka lidhur kontratë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe kujdes paliativ në QKMF-Viti, duke llogaritur nevojën dhe kërkesën e madhe për staf shëndetësorë.

Në këtë kontratë janë të angazhuar mjekë, stomatolog, infermier, mami, laborant, teknikë të farmacisë, vozitës si dhe punëtorë teknik, të cilët ofrojnë shërbime sipas nevojave, qoftë në QKMF, QMF apo AMF. Numri i stafit ka qenë variabil gjatë tërë vitit.

Cilësia e shërbimeve shëndetësore:

- Janë mbajtur takime të Këshillit Drejtues të QKMF-së në Viti,
- Është bërë me kohë plani i punës,
- Janë mbajtur takime me përgjegjësit e njësive, në mënyrë të evitimit të parregullsive dhe avancimit të shërbimeve sa më cilësore,
- Janë diskutuar në takime të rregullta planet, kërkesat dhe sfidat e çdo shërbimi,
- Kemi mbajtur takime të rregullta me administratën,

- Kemi formuar Komitetin e Cilësisë,
- Kemi takime regionale dhe komunat tjera për shkëmbim përvojash në ngritje të cilësisë,
- Jane mbajtur takime edhe sipas kërkesave të stafit,

Shërbimi i administratës

Buxheti i Shëndetësisë përbëhet nga granti specifik i shëndetësisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të hyrat vetanake. Për vitin 2025 ky buxhet ndahet si vijon:

- ▶ Paga dhe Meditje -1.385.661 €
- ▶ Mallra dhe shërbime 847.235€
- ▶ Shpenzimet Komunali 57.600€
- ▶ Shpenzimet kapitale 10.000€
- ▶ **Totali: 2.300.496 euro**

Shërbimi i administratës ka funksionuar me kapacitet të plotë, ku periudhës janar-dhjetor 2025 janë kryer këto punë:

- ▶ Kemi bërë shkresë zyrës së Prokurimit për shpalljen e tendereve të ndryshme dhe kemi përgaditur të gjitha paramasat dhe parallogarit për shpalljen e tenderave.
- ▶ Kemi bërë pagesën e kujdestarive për 11 muaj të vitit 2025.
- ▶ Ka vazhduar participimi I pagesave në të gjitha repartet e QKMF-së, ku në këtë periudhë deri me date 31.12.2025 janë inkasuar (grumbulluar) 95834.50 € për shërbimet e kryera.
- ▶ Kemi dhënë informacione të shumta për insitucione të ndryshme,

Njësia për resurse humane

Ka kryer këto aktivitete gjatë kësaj periudhe:

- ▶ Procesimi i dokumentacionit për pranimin e stafit te ri në organizatën tonë QKMF-Viti
- ▶ kompletimi i dosjeve
- ▶ Lëshimi i aktvendimeve
- ▶ Protokollimi i dokumentacionit
- ▶ Pushimet pa pagesë, vjetore, mjekësore dhe kërkesa të ndryshme
- ▶ Vendime për ndërprerje të marrëdhënies së punës
- ▶ Vendime për përvojën e punës,
- ▶ Procesverbale të takimeve,
- ▶ Aktvendime,

- ▶ Vërtetime, autorizime, deklarata, aktëpërcjellje dhe njoftime të ndryshme
- ▶ Ankesa
- ▶ Në Zyrën për çështje Juridike bëhet edhe rexhistrimi në librin për ardhje dhe shkuarje të punëtorëve.

Edukimi i vazhdueshëm profesional

- Ka vazhduar edukimi i vazhdueshëm profesional nga ana e mjekëve dhe infermierëve sipas planifikimit të temave profesionale që janë dërguar më parë për akreditim në Odën e Mjekëve dhe Infermierëve (OMK dhe OIK). Plani për EVP/2025 është përpiluar në bazë të kërkesave dhe interesimit të mjekëve të QKMF-Viti, ku nga kordinatori për EVP është përpiluar një pyetësore: "Vlerësimi i nevojave për trajnim të personelit", ku janë parashtruar temat dhe janë zgjedhë temat të cilat kanë qenë me më interes për zhvillimin profesional, për fitimin e njohurive dhe shkathtësive të reja, rifreskimin e njohurive të mëparshme
- Nga mjekët janë mbajtur 7 ligjërata.
- Nga infermierët janë mbajtur 12 ligjërata.
Janë realizuar trajnime të ndryshme me organizata të ndryshme, si :
- Trajnimi për vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë 13 punëtorë të trajnuar,
- Trajnimi për Kujdesi në grup për Prindërim, 14 punëtorë të trajnuara.
- Trajnimi për Sigurinë e shëndetit në vendin e punës dhe përdorimi adekuat i mjeteve për fikjen e zjarrit dhe mjeteve tjera, 130 punëtorë të trajnuar
- Trajnimi për të moshuarit, ME AQH, 6 të trajnuar,
- Trajnimi për PEN protokollet me AQH , 12 të trajnuar
- Trajnimi për keshillim motivues për sëmundje kronike , 12 të trajnuar
- Trajnimin "Parandalimi dhe Menaxhimi i konflikteve", PRAK, 25 të trajnuar
- Trajnim për GMCD "Përdorimi i Instrumentit për Monitorimin dhe Mbështetjen e Zhvillimit të Fëmijëve, 11 të trajnuar,
- Trajnim për Kujdesin antenatal dhe postnatal, 7 të trajnuar

Promovimi dhe edukimi shëndetësor gjate periudhes Janar-Qershor 2025 janë realizuar këto aktivitete :

- Me 31 Janar shënohet muaji i kancerit të qafës së mitrës,
- Me 14 mars shënohet Dita Botërore e Veshkave në Viti,
- Më 25 Mars është shënuar Java botërore e Tuberkulozit,
- Më 7 Prill Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti ka shënuar, Ditën Botërore të Shëndetit,
- Me 09 Prill ne QKMF-Viti mbahet ligjerata "Reanimimi Kardiopulmunar".
- ME 15 prill është prezantuar Auditi Klinik "Përdorimi i antibiotikëve në infeksionet e traktit respirator"
- Me 18 Prill Shenohet Dita Evropiane e të Drejtave të Pacientit.
- Me 30 prill eshte shënuar Java e Imunizimit në Viti.
- Me 2 maj shënohet Dita Ndërkombëtare e Mamive,
- Më 12 Maj Shënohet Dita Ndërkombëtare e Infermierit në Viti,
- Me 17 maj është shënuar Dita Botërore e Hipertensionit,
- Me 19 maj Dita Botërore e Mjekut Familjar,
- Me 30 Maj është shenuar Dita Botërore kundër Duhanit,
- Me 14 qershor është shënuar Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut me moton "Çdo dhurues gjaku është një HERO ". Kurse, me 23.06.2025 është mbajtur aktiviteti për dhurimin e gjakut, ku kanë dhuruar gjak 50 qytetarë,
- Është shënuar java e gjidhënies me moton " Ta mbështesim gjidhënien", nga 1-7 gusht 2025.
- Me 29 Shtator shënohet dita boterore e Zemres ne Viti.
- Me 1 tetor shënohet dita e Kancerit të gjirit.
- Me 10 tetor shënohet Dita Botërore e Shëndetit Mendor.
- Me 14 Nëntor shënohet Dita Botërore e Diabetit në Komunën e Vitisë.

Aktivitete tjera

- Vazhdon bashkëpunimi në mes të Komunës së Vitisë dhe AMC (Aksioni për nëna dhe fëmijë” për inplementimin e dy programeve të reja në QKMF-Viti, “Klasat për Nëna ” dhe “Kujdesi në grup në 1000 Ditët e Para ”, si dhe “Kujdesi në grup për prindërim”,
- Përcjellja e aktiviteteve sportive në nivel komunal,
- Përcjellja e aktiviteteve sportive me ekipe nga QKMF (skijimit) të organizuara nga Ministria e Kultures, Sportit, Ministria e Arsimit dh MSH “ Drejt Malit”
- Është mbajtur trajnimi i shumicës së stafit për” Sigurinë e shëndetit në vendin e punës dhe përdorimi adekuat i mjeteve për fikjen e zjarrit dhe mjeteve tjera” nga Njesia e Zjarrfikësve
- Është mbajtur trajnimi i infermierëve dhe vozitësve të autoambulancave për “Ngasjen emergjente” me Akademinë e Kosoves për Siguri Publike në Vushtri, në kordinim me Shtabin e Policisë në Prishtinë.
- Eshte mbajtur marshi sensibilizues per Kancerin e gjirit me moton “Lufto me Guxim”.
- Eshte mbajtur karavani shendetesore “Pershendeje” ne komunes e Vitise se bashku me AQH dhe OJQ Mundesia.
- Eshte mbajtur java Kosovare e Testimit per Hiv.

INVESTIMET KOMUNALE

- Renovimi në QKMF- Viti deh shërbimin e urgjencës
- Renovimi i AMF në Letnicë

DONACIONET

- QKMF në Viti konkretisht AMF ne Terpezë përfiton karrige stomatologjike nga Organizata "Qendresa Kosovare" me përkrahje nga Kuvajti
- Donacion per renovim te hapesirave ne QKMF dhe QMF-Pozheran nga AQH
- Donacione nga qytetare me karroca invalidore, qarqafe per sherbimin e urgjencës,
- Donacion nga KBI ne Viti,
- Donacion –
- Mamograf digjitale nga Kompania Medica Shpk.
- Donacion -pajisje mjekesore (Ekg,Monitor,Aparat hematologjik per laborator,tavoline per terapi ne urgjence,stetoskopa,pulsometer, inhalator) nga AQH

Planet për të ardhmen

- Jemi duke realizuar aktivitetet duke u bazuar në planin e punës për vitin 2025, ku do të jemi të përkushtuar në rritjen e kualitetit të shërbimeve shëndetësore .
- Kemi bërë planin detal për ngritjen profesionale të punëtorëve shëndetësorë si dhe objektiv kemi furnizimin e rregullt me barna dhe material hargjues per te gjitha njësitë e QKMF-së.
- Do të funksionalizojmë shërbimin e mamografisë së shpejti.
- Kemi bërë kërkesë për shtim të resurseve humane në MSH dhe MF.
- Kemi bërë kërkesë për ndërtimin e objektit të ri të QKMF-së, jemi në pritje të përgjigjes.
- Kemi bërë kërkesë për furnizim me autoambulancë të re

Sfidat

Sfidë në vazhdimësi mbetet numri i vogël i stafit shëndetësorë të rregullt, por këtë e kemi zgjedhur

përmes angazhimit të profesionistëve, në kuadër të marrëveshjes për shërbime shëndetësore dhe kujdes

paliativ. Numri jo i mjaftueshëm i Mjekeve Familjarë bazuar në numrin e banoreve, si dhe mungesa e Listës së pacientëve për Mjekë Familjar.

Mungesa e kësaj liste po ndikon në

ë mbingarkesën e shërbimit të urgjencës primare, pasi që pacientët edhe pse nuk janë raste akute apo urgjerne kërkojnë shërbime gjatë 24 orëve në QKMF

Sfidë tjetër mungesa e sistemit adekuat dhe efikase të mirëmbajtjes së objekteve dhe paisjeve të punës.


Rekomandimet

1. Krijimi i mekanizmave dhe instrumenteve motivuese në rritjen e numrit të mjekëve familjare me qëllim të përmbushjes së standardeve në mjekësinë familjare në raport me numrin e banorëve.
2. Të përditësohen Rregulloret ekzistuese dhe të hartohen rregullore të reja të domosdoshme për përmirsimin e cilësisë së shërbimeve.
3. Ngritja e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve në Departamentin e Administratës përmes trajnimeve profesionale, në fushën e burimeve njerëzore dhe menaxhimit të financave dhe kontabilitetit.
4. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetsore me angazhimin më të madh lidhur me ngritjen dhe përforcimin e kapaciteteve profesionale të personelit shëndetsorë, me ngritjen e nivelit të performancës së personelit, përmirësimin e komunikimit ndërmjet personelit me komunitetin dhe ndërmjet institucioneve si dhe me dizajnimin dhe përforcimin e mekanizmave dhe instrumenteve funksionale për monitorimin, mbledhjen, përpunimin dhe shkëmbimin e të dhënave si dhe evaluimin e punës.
5. Zbatimi i aktiviteteve sipas planit të punës për vitin 2025.
6. Komunikimet e vazhdueshme të përfaqësuesve të institucioneve shëndetësore publiko private, OJQ dhe komunitete.

Krahasimi i shërbimeve të ofruara për periudhat Janar-dhjetor 2022, 2023, 2024 dhe 2025

Sherbimet	Janar – Dhjetor 2022	Janar – Dhjetor 2023	Janar – Dhjetor 2024	Janar – Dhjetor 2025
Urgjenca	61410	66898	71977	66600
Mjekësia Familjare	42659	31944	31337	34709
Vizita Shtepiake nga sherbimi i urgjencës	1309	2006	2113	2179
Stomatologjia	2819	4305	10046	9760
Pediatra	3814	3811	3829	3537
Shërbimi internistik	795	805	1664	1564
Gjinekologjia	1814	2519	4844	4154
Vaksinimi I femijeve	3803	4471	2106	4689
Laboratori	122874	195930	115232	119960
Radiologjia	1093	1042	255	1307
Mamografia				124
Shërbime të kujdesit paliativ dhe kronik ne teren	2638	3012	4096	4400
Vizit për nëna dhe fëmijë në shtëpi	1268	1601	1360	1022
Vizitat sistematike në shkollat e Komunës e Vitisë, për klasat e I, V dhe IX-ta	1317	1418	1470	0
Vizita ne QMF Pozheran dhe AMF tjera	45677 - Pozheran 3308-Amf tjera	45726-Pozheran 8177- Amf tjera	42339-Pozheran 4175-Amf tjera	43782 1525
Participimi I pergjithshem	60051.3	73020.06	76459.7	95834.50
Buxheti	1.851.347,36	1.861.704,00	2.156.046	2.300.496
Totali i vizitave	172126	181340	183605	181561
Totali I shërbimeve 2025		501338	556760	490126

Krahasimi i shërbimeve të ofruara për periudhat Janar- dhjetor 2022, 2023, 2024 dhe 2025



Viti 2025